

P. nr.82/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja **DIANA SINA,** me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarve R. K. nga fsh. Ll. K. Pejë, H. U. nga fsh. S. K. Deçan, dhe kundër të akuzuarit N. Z. nga Gjakova, për shkak se secili veç e veç kanë kryer veprën penale, rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshem në Gjakovë, PP.nr.1074/2016 të datës 10.02.2016, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datën **21.04.2017,** në prani të Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, të akuzuarve, e dëmtuara, të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

1.I akuzuari **R. K. ,** i biri i A. dhe i ëmës M., e gjinisë C., i lindur me datën.... në fsh. Ll. K. Pejë, ku dhe tani banon, punëtor, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar-atë i 4 fëmijëve.

2.I akuzuari **H. U. ,** i biri i H. dhe i ëmës S., e gjinisë V., i lindur me datën..... në fsh. S. K. Deçan, ku dhe tani banon, punëtor në botën e jashtme në Francë, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar- atë i 4 fëmijëve.

3.I akuzuari **N. Z. ,** i biri i B. dhe i ëmës Gj. , e gjinisë G. , i lindur me datën..... në Gjakovë, ku dhe tani banon në rrugën....., punëtor, ka të kryer fakultetin, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar- atë i 4 fëmijëve.

J a n ë f a j t o r:

I akuzuari R. K.

Sepse: Me dt.09.08.2015 rreth orës 17.30 minuta, në aksin rrugor Gjakovë-Pejë, pikërisht në fshatin S. K. Gjakovë, nga pakujdesia rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 54 lidhur me nenin 352 të Ligjit për siguri në komunikacionit rrugor të Kosovës, dhe ven në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës VW Golf 19E me targa..... me ngjyrë të kaltër, nuk iu ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes, kushteve dhe rrethanave në rrugë, me veprim për frenim të vrullshëm, në distancë prej 2 metra, pas pasur rrezik të drejtpërdrejtë në rrugë, ku si pasoj goditet në pjesën e pasme të automjetit të tij, me pjesën e përparme të automjetit të markës “Citroen Pikaco” me targa, të cilën e drejtonte H. U., i cili në atë moment ishte duke lëvizur prapa tij, me ç’ rast përpos dëmeve materiale në automjete i dëmtuari H. H. U. së bashku me bashkë udhëtarin e tij H. U., pësojnë lëndime të lehta trupore, të cilat lëndime më gjerësisht janë të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore të dt.04.10.2015, nga eksperti mjeko ligjor Dr. M. G.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës.

I akuzuari H. U.

Sepse: Me datën, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin nën një të aktakuzës, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 126, lidhur me nenin 352 të Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor dhe ven në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurin, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës “Citroen Pikaco” me targa....., me ngjyrë të kuqe, duke mos mbajtur distancën e mjaftueshme me automjetin para tij, ku si pasoj me pjesën e përparme ballore të automjetin të tij, e godet në pjesën e pasme automjetin e markës “VW Golf 19E”, me targa..... të cilën e drejtonte R. K., i cili në momentin kritik ishte ndalur me vrull, ku përpos dëmeve materiale në automjete, me ç’ rast bashkë udhëtarëve të tij, këtu të dëmtuarve M. K. dhe K. K. ju shkakton lëndime trupore, të cilat lëndime më gjerësisht janë të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore të dt.04.10.2015, nga eksperti mjeko ligjor Dr. M. G.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës.

I akuzuari N. Z.

Sepse: Me datë ,kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin nën një të aktakuzës, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 126, lidhur me nenin 352 të Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor dhe ven në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurin, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës “Audi A4” me targa, me ngjyrë të zezë, duke mos mbajtur distancën e mjaftueshme me automjetin para tij, ku si pasoj përplasjet me pjesën e përparme frontale të automjetit të tij, duke goditur në pjesën e pasme automjetin e markës “Citroen Pikaco” me targa....., të cilën e drejtonte H. U., i cili në momentin kritik ishte duke lëvizur para tij në të njëjtin shirit të qarkullimit, ku përveç dëmeve të konsiderueshme materiale në automjete, me ç’ rast bashkë udhëtarëve të tij, tani të dëmtuarve V. Z., J. Z. dhe A. K., ju shkakton lëndime trupore, të cilat lëndime më gjerësisht janë të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore të dt.04.10.2015, nga eksperti mjeko ligjor Dr. M. G.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4,41,42,43,46,73 dhe nenit 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës, i

GJYKON

1.Të akuzuarin **R. K.** dënim me gjobë në shumë prej **200.- (Dyqindë) Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

2.Të akuzuarin **H. U.** dënim me gjobë në shumë prej **200.-(Dyqindë) Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

3.Të akuzuarin **N. Z.** dënim me gjobë në shumë prej **200.-(Dyqindë) Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do të iu zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **10 (Dhjetë) ditësh**, për secilin veç e veç duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.-€.(njëzet) euro, të gjobës.**

Detyrohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve procedurale penale, në emër të ekspertizës së komunikacionit të paguajnë shumën prej **40.88 Euro** në mënyrë solidare, në emër të

akt ekspertimit mjeko ligjor të paguajnë shumën prej **50.00** Euro, në mënyrë solidare, dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej **30,00.-Euro**, secili veç e veç, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

-Të dëmtuarit H. (H.)U., V. Z., J. Z., M. K., K. K. dhe A. K., për të realizuar kërkesën e tij pasurore –juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1074/2015, të datës 09.02.2016, kundër të akuzuarve R. K. nga fsh. Ll. K. Pejë, H. U. nga fsh. S. K. Deçan, dhe kundër të akuzuarit N. Z. nga Gjakova, për shkak se secili veç e veç kanë kryer veprën penale, rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-ës, Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu në shqyrtimin fillestar pasi lexoi aktakuzën bënë përmisimin sa i përket të dëmtuarve në këtë aksident komunikacioni, dhe atë në bazë të akt ekspertimit mjeko ligjor të dt.04.10.2015, të lëshuar nga eksperti mjeko ligjor Dr. M. G., dhe në këtë aksident komunikacioni të lënduar janë; H.(H.)U., V. Z., J. Z., M. K., K. K. dhe A. K., ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

I akuzuari **R. K.** në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë, deklaroi se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, këtë vepër penale e kam kryer pa dashje, por nga pakujdesia ime, shton se për herë të parë paraqitem në gjykatë për një vepër të kryer penale, por premtoi se edhe në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit, jam punëtor, jam mbajtës i vetëm i familjes, prandaj i propozoi gjykatës që të më shqiptoi një dënim sa më të butë.

I akuzuari **H. U.** në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë, deklaroi se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, shton se për herë të parë paraqitem në gjykatë për një vepër të kryer penale, por premtoi se kjo do të jetë edhe hera e fundit, për të parë kam shkaktuar një aksident komunikacioni, jam punëtor në botën e jashtme, jam mbajtës i familjes, nga puna ime mvaret familja, prandaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh këto rrethana me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

I akuzuari **N. Z.** në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë, deklaroi se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, shton se për herë të parë kam shkaktuar aksident komunikacioni por premtoi se në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit, jam njeri familjar, jam njeri i punës dhe mbajtës i familjes, prandaj i propozoi gjykatës që të më shqiptoi një dënim sa më të butë.

E dëmtuara V. Z. deklaroi se nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarve, unë si palë e dëmtuar nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale, ndërsa kompensimin e dëmit do ta realizoi nëpërmes kompanisë së sigurimit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që të akuzuarit kanë pranuar

fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe të njëjtit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet në faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin gjyqësor gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari R. K. : Me dt.09.08.2015 rreth orës 17.30 minuta, në aksin rrugor Gjakovë-Pejë, pikërisht në fshatin Skivjan K. Gjakovë, nga pakujdesia rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 54 lidhur me nenin 352 të Ligjit për siguri në komunikacionit rrugor të Kosovës, dhe ven në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës VW Golf 19E me targa....., me ngjyrë të kaltër, nuk iu ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes, kushteve dhe rrethanave në rrugë, me veprim për frenim të vullshëm, në distancë prej 2 metra, pas pasur rrezik të drejtpërdrejtë në rrugë, ku si pasoj goditet në pjesën e pasme të automjetit të tij, me pjesën e përparme të automjetit të markës “Citroen Pikaco” me targa....., të cilën e drejtonte H. U., i cili në atë moment ishte duke lëvizur prapa tij, me ç’ rast përpos dëmeve materiale në automjete i dëmtuari H. H. U. së bashku me bashkë udhëtarin e tij H. U., pësojnë lëndime të lehta trupore, të cilat lëndime më gjerësisht janë të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore të dt.04.10.2015, nga eksperti mjeko ligjor Dr. M. G.

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari H. U. : Me datën, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin nën një të aktakuzës, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 126, lidhur me nenin 352 të Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor dhe ven në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurin, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës “Citroen Pikaco” me targa....., me ngjyrë të kuqe, duke mos mbajtur distancën e mjaftueshme me automjetin para tij, ku si pasoj me pjesën e përparme ballore të automjetit të tij, e godet në pjesën e pasme automjetin e markës “VW Golf 19E”, me targa, të cilën e drejtonte R. K., i cili në momentin kritik ishte ndalur me vrull, ku përpos dëmeve materiale në automjete, me ç’ rast bashkë udhëtarëve të tij, këtu të dëmtuarve M. K. dhe K. K. ju shkakton lëndime trupore, të cilat lëndime më gjerësisht janë të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore të dt.04.10.2015, nga eksperti mjeko ligjor Dr. M. G.

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari N. Z. : Me datë ,kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin nën një të aktakuzës, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 126, lidhur me nenin 352 të Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor dhe ven në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurin, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës “Audi A4” me targa....., me ngjyrë të zezë, duke mos mbajtur distancën e mjaftueshme me automjetin para tij, ku si pasoj përplasat me pjesën e përparme frontale të automjetit të tij, duke goditur në pjesën e pasme automjetin e markës “Citroen Pikaco” me targa....., të cilën e drejtonte H. U., i cili në momentin kritik ishte duke lëvizur para tij në të njëjtin shirit të qarkullimit, ku përveç dëmeve të konsiderueshme materiale në automjete, me ç’ rast bashkë udhëtarëve të tij, tani të dëmtuarve V. Z., J. Z. dhe A. K., ju shkakton lëndime trupore, të cilat lëndime më gjerësisht janë të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore të dt.04.10.2015, nga eksperti mjeko ligjor Dr. M. G.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit, të cilët në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij

aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPP-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve: që të tretë janë njerëz familjar dhe mbajtës të familjes, pranimin e fajësisë, sjelljet korrekte në gjykim, pendimin e tyre, sjelljet e tyre para dhe pas kryerjes së veprës penale, e sidomos faktin që të tretë të akuzuarit për here të parë ndeshen me ligjin, nuk kanë qenë më parë të dënuar, andaj duke marr parasysh rrethanat e lartë cekura, Gjykata të akuzuarve R. K., H. U. dhe N. Z. secilit veç e veç iu shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej **200 (Dyqindë) Euro**, të cilën dënim janë të detyruar që ta paguajnë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor, dhe shpenzimeve të procedurës penale, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën paragraf 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.82/16 më datë 21.04.2017**

**Sekretarja juridike,
Lamije Kuqi**

**Gj y q t a r j a
Diana Sina**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.